



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2021:087587  
Datë: 21.02.2024  
Numri i dokumentit: 05350542

C.nr.849/21  
2021:087588

Gjykata Themelore në Ferizaj, me gjyqtarin Armend Ahmeti, në çështjen juridike të paditësit-propozuesit të sigurimit R.J. nga fshati ...-Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilin e përfaqëson e autorizuara av. Elvira Heta Vata nga Ferizaj, kundër të paditurit-kundërshtarit të sigurimit G.J. nga fshati ... - Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Lindon Azemi nga Ferizaj, për shkak anulimit të kontratës për dhurimin e paluajtshmërisë me propozim për marrjen e masës së sigurisë së përkohshme, vlera e kontestit 1000€, pas pranimit të parashtresës për tërheqjen e kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe për tërheqjen e padisë për anulimin e kontratës të autorizuarit të paditësit-propozuesit të sigurimit av. Elvira Heta Vata e datës 06.02.2024, jashtë seance me datë 21.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Konstatohet tërheqja e padisë dhe propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë së paditësit kundër të paditurit e paraqitur me datë 07.05.2021, për shkak të anulimit të kontratës për dhurimin e paluajtshmërisë.

II. Shfuqizohet aktvendimi C.nr.849/21, i datës 07.05.2021 i Gjykatës Themelore në Ferizaj për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, përmes së cilës i ndalohet kundërpropozuesit – të paditurit G.J. nga fshati ...-Komuna Ferizaj, ashtu që i'u ndalohet lidhja e kontratës së shitblerjes tek noteri, tjetërsimi te personat e tretë, vërja në hipotekë apo ndryshimin e gjendjes ekzistuese në njësitë kadastrale 1..-1 me sipërfaqe 651 m2, në vendin e quajtur “F.-O.”, Zona Kadastrale D., Komuna Ferizaj, të cilat paluajtshmëri janë të evidentuara në emër të të paditurit – kundërpropozuesit G.J.

### III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

#### A r s y e t i m

Me datë 07.05.2021 paditësi-propozuesi i sigurimit ka paraqitur padi kundër të paditurit për shkak anulimit të kontratës për dhurimin e paluajtshmërisë me propozim për marrjen e masës së sigurisë së përkohshme, vlera e kontestit 1000€. Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Elvira Heta Vata pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 29.01.2024 për shqyrtimin e kundërshtimit të parashtruar nga i padituri-kundërshtari i sigurimit lidhur me masën e përkohshme të caktuar nga gjykata sipas propozimit të paditësit-propozuesit të sigurimit, i kanë dorëzuar me dt. 06.02.2024 gjykatës parashtrësë për tërheqjen e kërkesës për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë dhe për tërheqjen e padisë për anulimin e kontratës në të cilën theksojnë se i drejtohen gjykatës që të liroj nga masa e përkohshme e sigurisë këtë ngastër, e poashtu e tërheqim padinë e parashtruar për anulimin e kontratës. Me këtë masë të njoftohet Drejtoria për Kadastër në Ferizaj si dhe noterët e Komunës së Ferizajt, si kompetent për vërtetimin e kontratave të shitblerjes dhe transaksione të tjera. Këtë parashtrësë për tërheqje të padisë dhe anulimin e dorëzohet në gjykatë, pasi paditësi me vullnetin e tij të plotë, është deklaruar para noterit se e tërheq të njëjtën, dhe këtë deklaratë e ka sjellë në zyrën e avokatisë, shtojcë: Deklarata nën betim nr. LRP.nr.1.../2024 e datës 06.02.2024, e nënshkruar para noterit G.H. në Ferizaj.

Meqenëse i padituri ka dhënë përgjigje në padi, gjykata parashtrësën e paditësit ia ka dorëzuar të paditurit, përkatësisht të autorizuarit të tij av. Lindon Azemi nga Ferizaj, i cili në parashtrësë nuk është deklaruar në afatin 7 ditor (ose nuk e ka njoftuar gjykatën se e kundërshton tërheqjen e padisë).

Meqenëse i padituri në afatin e dhënë ligjor nuk është deklaruar mbi deklaratën për tërheqjen e padisë dhe masës së sigurisë së përkohshme, konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqje. Prandaj gjykata me aplikimin e nenit 261.2 të LPK lidhur me nenin 381.1, pika c) të LPK nxjerrë aktvendim si në dispozitiv dhe konstatohet tërheqja e padisë dhe masës së sigurisë së përkohshme.

Sipas pikës II. të dispozitivit të këtij aktvendimi meqenëse paditësi-propozuesi i sigurimit me vullnetin e tij të plotë e ka tërhequr propozimin për caktimin e masës së sigurisë së përkohshme, kurse meqenëse më parë ishte e caktuar masa e përkohshme lidhur me këtë çështje edhe atë sipas aktvendimit C.nr.849/21, i datës 07.05.2021 të kësaj gjykate, janë plotësuar kushtet që të shfuqizohet aktvendimi C.nr.849/21, i datës 07.05.2021 i Gjykatës Themelore në Ferizaj për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Meqenëse i padituri-kundërshtari i sigurimit përkatësisht i autorizuari i tij av. Lindon Azemi nga Ferizaj, nuk është deklaruar në afatin 7 ditor (ose nuk e ka njoftuar gjykatën se e kundërshton tërheqjen e padisë) si dhe nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale, gjykata vendosi që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës konform nenit 450 të LPK.

Andaj nga të gjitha të lartëcekurat, e konform nenit 142, par. 1, 2 dhe 5 lidhur me nenin 309.1 të LPK u vendosë si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjyqtari,  
Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 261.4 të LPK.